L I G J
Nr. 8863, datë 7.3.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7710, DATË 18.5.1993 "PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7785, DATË 27.1.1994, NR.7886, DATË 8.12.1994, NR.8008, DATË 5.10.1995 DHE NR.8721, DATË 26.12.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", ndryshuar me ligjet nr.7785, datë 27.1.1994, nr.7886, datë 8.12.1994, nr.8008, datë 5.10.1995 dhe nr.8721, datë 26.12.2000, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

Në zbatim të këtij ligji krijohet Shërbimi Social Shtetëror, në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm i këtij shërbimi.

Këshilli i Ministrave miraton Statutin e Shërbimit Social Shtetëror, i cili rregullon veprimtarinë e këtij institucioni dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Administrativ dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të tij.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3270, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani